



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
Bordi i Administrimit

Nr. 1303 Prot

Shkodër, me 15.04 2024

V E N D I M

Nr. 110 datë 15 . 04 .2024

**" Për miratimin e buxhetit 2024 "**

Bazuar në ligjin e AL nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe të kërkimit shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar),ligjit nr.97/2023"Për buxhetin e vitit 2024" VKM nr.75 datë 12.02.2018 , "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor",Udhëzimit nr.1 datë 24.01.2024 të MFE "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", udhëzimit të përbashkët nr.20 datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"(i ndryshuar) dhe me vendim të Senatit Akademik nr.99 datë 05.04.2023

**Vendosi:**

1. Miratimin e buxhetit për vitin 2024 të Universitetit të Shkodrës"Luigj Gurakuqi"sipas materialit bashkengjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori i USH për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Bordit të Administrimit**

**Prof. As.Dr. Adria LEKA**







Republika e Shqipërisë

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Administratori

**Lënda: Mbi realizimin e buxhetit vjetor 2023 dhe planin buxhetor vjetor 2024  
Senatit Akademik të Universitetit të Shkodrës**

Materiali i buxhetit paraqitet pranë jush në mbështetje të: ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", si dhe të Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE " Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr. 75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", shkresës së MAS (Email) datë 04.01.2024 në të cilin jepen fondet e miratuara për vitin 2024, VBA nr. 2, datë 05.01.2024 "Për detajimin e grantit 2024 (grant i mësimdhënies), Senatit Akademik/ Bordit të Administrimit i paraqitet "Relacion mbi realizimin e buxhetit vjetor 2023 dhe Plan buxheti vjetor 2024", bazuar në kërkesat e fakulteteve

**1. Tregues të përgjithshëm**

Disa tregues strukturorë, ekonomikë e financiarë, me të cilët paraqitet Universiteti, në vitin akademik 2023-2024, mbi të cilin bazohet buxheti i vitit 2024 .

Universiteti i ushtron funksionet e tij akademike dhe administrative nëpërmjet Rektoratit , fakulteteve të ndara në njësitë bazë akademike e kërkimore.

**➤ Organizimi i strukturave**

**A. Rektorati**

- ◇ Rektor
- ◇ Zv/Rektor
- ◇ Administrator
- ◇ Drejtori/Njësi
- ◇ Biblioteka

**B. Fakultetet**

- ◇ Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- ◇ Fakulteti i Shkencave Shoqërore
- ◇ Fakulteti i Drejtësisë
- ◇ Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- ◇ Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
- ◇ Fakulteti Ekonomik

Në strukturën e Universiteti bëjnë pjesë gjithashtu edhe dy Qendra Kërkimore:

Qendra Kërkimore e Albanologjisë

Qendra e Studimit të ujërave në rajonin e Shkodrës.

Të cilat përfshihen respektivisht në Fakultetin e Shkencave Shoqërore dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës.





➤ **Personeli akademik dhe personeli ndihmës**  
(Ndhmës akademik me karakter administrativ dhe administrativ)

Në Universitetin e Shkodrës numri i punonjësve në dhjetor 2023 është 321 Punonjës punonjës akademikë, ndihmës akademikë e administrativë. Nga numri i punonjësve efektivë të Universitetit, 63% janë punonjës akademikë e 37% punonjës ndihmës akademikë e administrativë.




Numri i punonjësve në UNISHK parashikohet të jetë për vitin 2024, 354 punonjës me kohë të plotë dhe 295 me kohë të pjesëshme.

Nga numri i punonjësve efektivë të Universitetit parashikohet 67 % punonjës akademikë dhe 33 % punonjës ndihmës akademikë e administrativë.

### ➤ Shtrirja dhe mjediset

UNISHK e ushtron veprimtarinë e tij mësimore në territorin e qytetit të Shkodrës.

Sipërfaqja e mjediseve mesimore



Aktualisht UNISHK ka në administrim (vlerë kontabël ) 8 godina dhe është në proces regjistrimi i tyre.



## A. Realizimi i plan buxhetit të vitit 2023

Për vitin 2023 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën **729,526** mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2022	Financimi (Buxheti/ të ardhura) viti 2023	Buxheti viti 2023
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	182,781,146	599,147,476	781,928,622
<b>TOTALI</b>		<b>182,781,146</b>	<b>599,147,476</b>	<b>781,928,622</b>

### a.1. Të ardhurat e vitit 2023

Hyrjet e fondeve për Universitetin për vitin 2023 përveç akordimeve nga Buxheti i Shtetit janë dhe të ardhurat që sigurohen nga arkëtimet që paguajnë studentët, shërbimet ndaj të tretëve dhe disbursimet nga financimet e huaja.

Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e USH - së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën **95,625 mijë lekë**.

### a.2. Shpenzimet e vitit 2023

Plan buxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) ka vlerën 771,867 mijë lekë dhe është realizuar financiarisht në vlerën **671,690 mijë lekë**, ose 71.6%

Tabela Përmbledhëse sipas kategorive të shpenzimeve dhe realizimit financiar si më poshtë:

Realizimi viti 2023 000/lekë										
Dlog	Pershkrimi	Granti			Të ardhura			USH		
		Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%
600	Paga	484,316	464,322	95.9	52,000	45,568	87.6	536,316	509,890	95.1
601	Sigurime	73,591	73,051	99.3	8,400	6,734	80.2	81,991	79,785	97.3
602	Shpenzime operative	139,505	83,881	60.1	28,017	12,623	45.1	167,522	96,504	57.6
606	Bursa Studentëve	74,455	50,436	67.7	0	0	0.0	74,455	50,436	67.7
230/231	Investime	0	0	0.0	161,874	18,639	11.5	161,874	18,639	11.5
<b>TOTALI</b>		<b>771,867</b>	<b>671,691</b>	<b>87.0</b>	<b>250,291</b>	<b>83,564</b>	<b>33.4</b>	<b>1,022,158</b>	<b>755,254</b>	<b>73.9</b>



Sipas burimeve të financimit

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues-investime nga buxheti,) dhe Grantet për shpenzime korrente e bursat e studentëve në vlerën 87%
- Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga vitet e mëparëshme) të në vlerën 29.5%.



#### ➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Pagat për periudhën janar-dhjetor 2023 janë mbuluar me fondet nga Granti për shpenzime korrente dhe te ardhurat e Institucionit. Plani vjetor i pagave është në vlerën 536,316 mije lekë, ndërsa realizimi në nivelin 509,890,mije lekë ose 95.1%.

#### ➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore, si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është planifikuar në vlerën 81,991 mije lekë dhe është realizuar në vlerën 79,785 mije lekë ose 97.3%.

#### ➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Për vitin 2023 shpenzimet operative janë parashikuar të përballohen nga granti për shpenzime korrente dhe nga të ardhurat. Këto shpenzime janë realizuar financiarisht për periudhën janar-Dhjetor 2023 në masën 57.6% e fondit të çelur për këtë qëllim: nga granti 60.1 % dhe nga të ardhurat 45.1% e planit vjetor. Shpenzimet operative për vitin 2023, janë realizuar kryesisht për: ruajtjen e godinave, elektricitet, mirëmbajtje, taksa e tarifa te insitucionit etj. Sic u theksua, relizimi finaciari është në nivelin 57.6% por nëse analizojmë situatën nga pikpamja e realizimit te procedurave, situata ndryshon pasi pavarësisht realizimit të procedurave, finalizimi me pagesë ka qene i pamundur te realizohej brenda vitit 2023 per shkaqe objektive. Kjo konkretisht per kancelarine. Pervec ketyre, jane edhe raste kur sherbimi nuk eshte objekt prokurimi dhe realizimi eshte nen nivelin e buxhetuar, per skaqe objektive, si psh elektricitet, uje, taksa dhe tarifa (nuk jane realizuar akreditime programesh), udhetime.

#### ➤ **Transferta tek individët bursat e studentëve– Artikulli 606**

Realizimi i këtij zëri është në vlerën 50,436 mije leke nga 74,455 mije leke të miratuara.

#### ➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen në formën e mëposhtme. Shpenzimet ne kodet e llogarive 230 dhe 231 jane realizuar financiarisht ne masen 11.5%.

Ne kete drejtim duhet te ndalemi pak. Pagesat e ndaj furnitoreve kane vleren 18,639 mije leke ndaj 161,874 mije leke te buxhetuara. Ne miratimin fillestar te buxhetit, ishin



parashikuar investime nga te ardhurat e institucionit ne vleren 195,224 mije leke. Me vendimet e organeve kolegjiale per rritjen e pagave te stafit akademik ne nivelin maksimal, u vendos qe per zerat e investimeve ne tablen me poshte te mos jene me ne buxhetin e vitit, pasi per shkaqe objektive ishte i pamundur realizimi i tyre dhe vlerat perkatëse te kalonin ne dispozicion te pagave dhe sigurimeve.

Nr	Kodi i Programit	Artikulli	Kodi I Projektit	Kodi i llogarisë treshifrore	Emertimi I Investimit	Vlera
1	09450	06	A000001	231	Laboratori I Ushqimit dhe pijeve fakulteti ekonomik	13,307,000
2	09450	06	A000001	231	Digitalizimi I anatomise kardiake fetale dhe diatrike, reabilitimi post kirurgjikal	14,490,000
3	09450	06	A000001	231	Laboratori i Multimedias	2,953,000
4	09450	06	A000007	231	Ashensori tek FSHE	2,600,000
					<b>TOTAL</b>	<b>33,350,000</b>

Pervec sa me siper, per zerat ne vijim eshte realizuar procedura dhe perfshihen ne buxhetin e vitit 2024 vetem per efekt se fondet do te dalin nga buxheti i ketij viti. Për efekt analize të realizimit, vlerat më poshtë janë vlerat e buxhetuara dhe jo ato të kontratave.

Emertimi i projektit te investimit	Projekt Buxheti 2023		Komente
	Buxhet	Ardhura	
Pajise elektronike		37,313,842	Realizuar procedura, kthyer nga KPP per arsyete ankesash, do te realizohet si procedure e re ne vitin 2024
Pajise per inventar ekonomik		5,030,000	Realizuar procedura plotesisht, vetem pagesa gjate viti 2024.
Furnizim Vendorsje Kondicionere		6,500,000	Realizuar procedura plotesisht, vetem pagesa gjate viti 2024.
T-VSH projekti U2SID pajise		600,000	Paguar
Rishikim Projekti ndricimi I objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave		120,000	Paguar
Supervizim ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave		252,000	Realizuar procedura kemi fituesin
Investim per ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave		15,000,000	Realizuar procedura plotesisht, vetem pagesa gjate viti 2024.
Projekti I catise se FSHE		562,000	Paguar
Rikonstrukcion catia e FSHE		14,000,000	Realizuar procedura plotesisht, vetem pagesa gjate viti 2024.
Laboratori i analizave te ushqimeve		15,000,000	Realizuar procedura, dale fituesi, per pagese gjate vitit 2024
Digitalizimi i shtypshkronjes		18,000,000	Paguar
Departamenti i historise Korniza		100,000	Paguar
Infermiera stenda		80,000	Paguar
10 aparate tensioni		30,000	Paguar
Flamure per cdo godine		270,000	Paguar
Fshese me korrent		20,000	Paguar
	-	<b>112,877,842</b>	





Përveç sa më sipër, duhet theksuar që:

Softet informatike, me vlerë 2 milionë leke nuk është realizuar pasi nuk kanë ardhur asnjëherë specifikat e nevojshme nga fakulteti që e ka kërkuar

Blerjet e librave me vlerë 3 milionë leke nuk janë realizuar pasi nuk kanë ardhur specifikimet nga fakultetet.

Realizimi viti 2023 000/lekë										
Ilog	Pershkrimi	Granti			Të ardhura			USH		
		Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%	Plan	Realizimi	%
600	Paga	484,316	464,322	95.9	52,000	45,568	87.6	536,316	509,890	95.1
601	Sigurime	73,591	73,051	99.3	8,400	6,734	80.2	81,991	79,785	97.3
602	Shpenzime operative	139,505	83,881	60.1	28,017	12,623	45.1	167,522	96,504	57.6
606	Bursa Studentëve	74,455	50,436	67.7	0	0	0.0	74,455	50,436	67.7
230/231	Investime	0	0	0.0	161,874	112,878	69.7	161,874	112,878	69.7
TOTALI		771,867	671,691	87.0	250,291	177,803	71.0	1,022,158	849,493	83.1

Nese merren si te realizuara edhe keto zera kemi:

Realizimi 112,878 mije leke

Buxheti 161,874 mije leke

Realizimi ne %: 69.7%

Duhet patur parasysh gjithashtu qe Laboratori i ushqimit dhe pijeve i fakultetit ekonomik ne vleren 13,307 mije leke nuk eshte realizuar per shkaqe kretesisht te pavarura nga strukturat e Administrates.

## B. Plan buxheti i vitit 2024

Hartimi i buxhetit të vitit 2024 është bazuar në projektet e paraqitura në periudhën e hartimit të p/buxhetit 2024-2026, në ndryshimet e ndodhura pas miratimit të tij; strukturën organizative, programet e studimit, numrin e studentëve të regjistruar në vijimësi, numrin e studentëve të padiplomuar, realizimit të planbuxhetit të mëparshëm, fondeve të trashëguara të përdorura nga viti 2023, niveli i financimit nga Buxheti i Shtetit (Granti i mësimdhënies).

MASR me (Email), datë 04.01.2024 ka dërguar “Fondet e miratuara për vitin 2024” në vlerën 625,150.8 mijë lekë, fonde të cilat janë detajuar për përdorim (për shlyerjen e detyrimeve: paga e detyrime tatimore të muajit dhjetor 2023) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në Degën e Thesarit Shkodër), sipas VBA nr. 2, datë 05.01.2024 “Për detajimin e grantit 2024 (grant i mësimdhënies)”.

*Në zbatim të akteve ligjore e n/ligjore për Buxhetin e Arsimit të Lartë Publik, janë organet drejtuese të tyre që ndajnë këto fonde të ngurtësuar për përdorim, për mësimdhënie e për bursa financiare. Këto grante nuk mund të përdoren për investime.*



Udhëzimi i përbashkët i MFE-së dhe MASR-s nr. 20, datë 20.09.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor", përcakton se fondi i grantit të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, i papërdorur gjatë vitit buxhetor, mbartet në vitin buxhetor pasardhës. Sipas aktrakordimit me Degën e Thesarit Shkodër ky fond i papërdorur në vitin 2023 është në vlerën 112,278 mijë lekë dhe është proceduar, sipas përcaktimeve në udhëzim për përdorimin e tij në vitin 2024.

Sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit Shkodër (me email) fondi i papërdorur nga të ardhurat e çelura për përdorim në vitin 2023 dhe grumbullimi i tyre gjatë këtij viti dhe i trashëguar është në vlerën 425,126 mijë lekë dhe është proceduar, sipas përcaktimeve në udhëzim për përdorimin e tyre në vitin 2024. Gjatë vitit 2024 është parashikuar të grumbullohen të ardhura në vlerën 90,000 mijë lekë.

Tërësia e financimeve dhe përdorimi i tyre për mbarëvajtjen e aktivitetit për të cilin funksionon Universiteti, përbën buxhetin e vitit 2024 në vlerën 1,252,554 mijë lekë. Buxheti paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë:

Fonde të mbartura, financimi Granti dhe të ardhura për vitin 2024				Plani	mije lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2023	Financimi (Buxheti/ të ardhura) viti 2024	Buxheti viti 2024	
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	112,278	625,150	737,428	
2	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	425,126	90,000	515,126	
<b>TOTALI</b>		<b>537,404</b>	<b>715,150</b>	<b>1,252,554</b>	

Ky buxhet përbëhet nga:

◇ Fonde të mbartura nga viti 2023 prej 537,404 mijë lekë, të disponueshme në Degën e Thesarit të cilat përfshijnë:

- fondin e mbartur të financuar nga Buxheti i Shtetit prej 112,278 mijë lekë;
- të ardhurat e trashëguara të institucionit prej 425,126 mijë lekë;

Fonde të vitit 2024 prej 715,150 mijë lekë, të cilat përfshijnë

- financimin nga Buxheti i Shtetit i fondeve të miratuara për vitin 2024 prej 625,150 mijë lekë;
- të ardhurat e parashikuara për tu grumbulluar të institucionit prej 90,000 mijë lekë.

### 1. Hyrjet e fondeve për vitin 2024

Në hyrjet e fondeve për Universitetin bëjnë pjesë:

- ◇ Financimi nga Buxheti i Shtetit: Granti konkurrues, Granti për kërkimin shkencor.
- ◇ Granti për mësimdhënie e transfertat tek individët (fondi i bursave për studentët e Ciklit të parë të studimeve),
- ◇ Disbursimet nga projektet me financim të huaj.
- ◇ Të ardhurat e vetë institucionit.



➤ **Financimi nga Buxheti i Shtetit**

Financimi nga Buxheti i Shtetit, bazuar në aktet për financimin e Arsimit të Lartë përbëhet nga

- ◇ Granti për mësimdhënie në ciklin e parë të studimeve.
- ◇ Transferrat tek studentët – fondet për bursat financiare.
- ◇ Granti konkurrues – për projektet e investimeve nga Buxheti i Shtetit.
- ◇ Granti i kërkimit shkencor.

Sipas të dhënave në tabelën e mësipërme financimi nga Buxheti i Shtetit është 737,429 mijë lekë

Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2024				mije lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2023	Financimi (Buxheti/ të ardhura) viti 2024	Buxheti viti 2024
1	Granti mësimdhënies	83,961	575,361	659,322
2	Granti i bursave të studentëve cikli parë	26,685	49,789	76,474
3	Granti Konkurrues	0	0	0
4	Granti Kërkimit shkencor	1,633	0	1,633
5	TVSH- Projekte të huaja	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>112,278</b>	<b>625,151</b>	<b>737,429</b>

➤ **Të ardhura të institucionit**

Fondet të kushtëzuar - të ardhurat e institucionit arkëtohen në bazë të akteve ligjore mbi të cilat është marrë vendim nga Bordi i Administrimit për tarifat e shkollimit dhe tarifave të tjera që arkëtohen nga studentë e shërbime ndaj të tretëve. Këto të ardhura përdoren për financime të aktivitetit akademik, kërkimor e zhvillimin infrastrukturës së universitetit

Fonde të mbartura, financimi Granti dhe të ardhura për vitin 2024				000/lekë
Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2023	Financimi (Buxheti/ të ardhura) viti 2024	Buxheti viti 2024
1	Të ardhura për shpenzime korente	112,063.35	80,000	192,063
2	Të ardhura për investime	313,062.67	10,000	323,063
<b>TOTALI</b>		<b>425,126.02</b>	<b>90,000</b>	<b>515,126</b>




Të ardhurat e institucionit për vitin 2024 janë 515,126 mijë lekë, nga të cilat, sipas kohës së arkëtimit janë:

- Të ardhurat e grumbulluara e të papërdorura për vitin 2023 në vlerën 425,126 mijë lekë
- Të ardhurat e parashikuara për vitin 2024 në vlerën 90,000 mijë lekë

Të ardhurat e institucionit për vitin 2024, sipas përdorimit në aktivitetin akademik janë:

- Të ardhura për shpenzime korente prej 192,063 mijë lekë, përbëhen nga; fondi i mbartur nga viti 2023 në vlerën 112,063 mijë lekë, financimi nga të ardhurat e vitit 2024 në vlerën 80,000 mijë lekë.
- Të ardhura për investime prej 323,063 mijë lekë, përbëhen nga; fondi i mbartur nga viti 2023 në vlerën 313,063 mijë lekë, financimi nga të ardhurat e vitit 2024 në vlerën 10,000 mijë lekë.

Në planifikimin e grumbullimit të ardhurave janë marrë; të dhënat mbi numrin e studentëve, tarifën e shkollimit, sipas niveleve të studimit për vitin akademik 2023-2024



Pesha e tarifave tek të ardhurat e parashikuara të institucionit si vijon:

- Tarifat e shkollimit 82.3 %,
- Të ardhura tjera 14.8%
- Tarifa regjistrimi 2.7 %
- Tarifa konkurrimi 0.2%

Në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", kostoja e një studenti mbi bazën e të cilës referohet vendosja e tarifave të shkollimit, që duhet të paguajë studenti, rezulton më e lartë se tarifën e ngarkuara, ndërkohë që tarifa e shkollimit nuk mund të jetë më e lartë se kufiri maksimal i vendosur me VKM-n nr. 288 datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar.



Tarifat e shkollimit aktualisht në fuqi për të gjitha programet e studimit në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" bazuar në vendimin e BA nr 230 dt 06.10.2023 për ciklin e parë dhe për ciklin e dytë, janë:

- a) Në Ciklin e parë të studimeve tarifa vjetore e shkollimit është:
- Për program të parë studimi – Bachelor 20,000 lekë, përvec DIND në Drejtësi, Bachelor në Psikologji, Bachelor në punë sociale, Bachelor Pikturë grafike dhe Pedagogji Muzikore. Tarifa për DIND në Drejtësi , Bachelor në Psikologji dhe Bachelor në punë sociale, – 25,000 Lekë. Tarifa për Bachelor në pikturë grafike dhe Bachelor në Pedagogji Muzikore 27,000 Lekë.
  - Për program të dytë studimi – Bachelor tarifa është 50,000 lekë përvec DND në Drejtësi që është 25,000 Lekë.
  - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi – Bachelor dhe programe profesionale dy vjeçare, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore 10,000, 12,500 ose 13,500 lekë në varësi të programit të studimit. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore.
- b) Në Ciklin e dytë të studimeve "Master profesional", tarifa për çdo kredit është:
- Për program të parë studimi 1,000 lekë/kredit nëse është me 60 pikë kredite për program të parë studimi dhe 1,200 lekë për program të dytë, me përjashtim të masterit profesional në gjuhë gjermane, italiane dhe frenge dhe të masterit profesional në mesuesi histori gjeografi dhe gjuhë letersi.
- c) Në Ciklin e dytë të studimeve "Master i shkencave", tarifa për çdo kredit është:
- Për program të parë dhe të dytë studimi 833.3 lekë/kredit për Master i Shkencave në FD, në studime regjionale në gjeografi, studime të historisë dhe kultures shqiptare, etnokulture dhe letersi shqipe dhe studime të thelluara në gjuhësi.
  - Për program parë dhe të dytë studimi 1,000 lekë/kredit.

## 2. Shpenzimet për vitin 2024

Buxheti i shpenzimeve i vitit 2024 mbulohet nga të hyrat e fondeve në universitet: Financimi nga Buxheti i Shtetit: Granti për mësimdhënie e transfertat tek individët (fondi i bursave për studentët e Ciklit të parë të studimeve), Granti konkurrues, Granti për kërkimin shkencor, disbursimet nga projektet me financim të huaj, të ardhurat e vetë institucionit, duke i ndarë sipas zërave të shpenzimeve buxhetore. Ky buxhet synon të vendosë themele të qëndrueshme për vitet në vazhdim.



<i>Plan Buxheti i Shpenzimeve për vitin 2024 000/Lekë</i>					
<i>Nr</i>	<i>Emërtimi shpenzimit</i>	<i>Artik.</i>	<i>Grant</i>	<i>Të ardhura</i>	<i>Total Buxheti</i>
1	<b>Paga e shpërblime</b>	600	472,923	45,000	517,923
	- Pagat	600	472,923	45,000	517,923
2	<b>Sig. Shoqërore</b>	601	80,282	3,000	83,282
3	<b>Shpenzime operative</b>	602	105,097	37,194	142,291
4	<b>Bursa</b>	606	76,474	0	76,474
5	<b>Investime</b>	230/231	-	155,201	155,201
	<i>Totali</i>		734,776	240,395	975,171

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600**

Fondi i llogaritur për paga nga granti i ardhur në fillim të vitit 2024, është parashikuar në vlerën 453,230 mijë lekë. Kjo duke marrë në konsideratë që grant të trashëguar kemi në vlerën 19,693 mijë lekë, gjë që bën që fondi i pageve nga granti të arrijë vlerën totale 472,923 mijë lekë. Ky fond, është në gjendje të mbulojë shpenzimet e pagave për numrin e stafit të parashikuar në vendimmarje dhe këtë vit buxhetohen edhe 45,000 mije lekë për paga nga të ardhurat për efekt të pagës së stafit akademik.

➤ **Sigurime shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601**

Fondi i llogaritur për sigurime shoqërore nga granti i ardhur në fillim të vitit 2024 është parashikuar në vlerën prej 79,742 mijë lekësh. Kjo duke marrë në konsideratë që grant të trashëguar kemi në vlerën 539 mijë lekë, gjë që bën që fondi i sigurimeve të arrijë vlerën totale 80,282 mijë lekë që përballon nevojat deri në fund të vitit. Krahas efektit nga rritja e pagave, për llogaritjen e këtij fondi është parashikuar edhe mundësia e rritjes së nivelit maksimal të pagës për kontribut. Këtë vit buxhetohen edhe 3,000 mije lekë për sigurime nga të ardhurat.


➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602**

Këto shpenzime janë planifikuar në vlerën 142,291 mijë lekë. Ky shpenzim do të përballohet nga:

- Granti për mësimdhënie janë detajuar shpenzime operative në vlerën 105,097 mijë lekë për përballimin e shpenzimeve të drejtpërdrejta: Ujë, energji, telefon, shërbime ruajtje, e shpenzime të tjera operative dhe një pjese të shpenzimeve në kuadrin e jubileve të sipërpërmendura.
- Të ardhurat e vetë institucionit në vlerën 37,194 mijë lekë.

Planifikimi në këto nivele do të mundësojë përballimin e shpenzimeve në rritje në disa zëra, si: energji, ngrohje si pasojë e rritjes së cmimit të naftës, materiale zyre si pasjë e rritjes së cmimit, ujë, telefon; në shërbimet që dalin të detyruara, si p.sh.: shpenzimet për sinjalin e internetit, shpenzimet për shërbimin e ruajtjes e sigurisë, etj. Funksionimi i sistemit të





ngrohjes qendrore në tërë godinat paraqet nevojën për shpenzime për lëndë djegëse. Ndarjen për çdo artikull e kemi llogaritur duke u nisur nga fakti i artikujve të vitit të kaluar, si dhe nga kërkesat në rritje për disa lloj shpenzimesh.

Grupi “Shpenzime udhëtimi” përfshin pagesën për: udhëtim e dieta brenda vendit, jashtë vendit dhe ekspedita.

✓ ***Kancelari në vlerën 5,441 mijë lekë.***

Blerja e kancelarive është shpenzim i vazhdueshëm, pasi ato janë marteriale konsumi. Ndër kancelaritë janë tonera e cartridge për printera e fotokopje, që kanë çmim të konsiderueshëm për njësi. Për vitin 2024 janë parashikuar 5,441 mijë lekë për kancelari nisur edhe nga shpenzimet shtesë të aktiviteteve që planifikohen të zhvillohen. Blerja e tyre kryhet e përqëndruar për organizimin ekonomik me financë në Rektorat, që ka ky universitet, sipas kërkesave të fakulteteve për kancelari.



Artikulli	Emertimi	Parashikimi 2024		
		Total	Grant	Të ardhura
	<<Emertimi i Programit>>			
		11,391,033	9,771,033	1,620,000
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	5,441,033	5,441,033	0
6020100	Kancelari	1,200,000	1,200,000	
6020200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndricim	1,200,000	1,200,000	0
6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyles	120,000	120,000	
6020400	Materiale per funksionimin e pajisjeve speciale	1,500,000		1,500,000
6020400	Materiale per funksionimin e paisje te shtypshkronjes.	610,000	610,000	
6020500	Blerje dokumentacioni	1,200,000	1,200,000	
6020900	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjithshme	120,000		120,000
6020900	Kuti dhe materiale te tjera zgjedhore	3,630,000	2,790,000	840,000
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	500,000	500,000	
6021001	Uniforma veshje dhe pajisje te tjera speciale	120,000	120,000	
6021002	"Blerje lule dhe vazo per dekorim te ambjenteve te Universitetit	120,000	120,000	0
6021003	Ilaçe, materiale dhe proteza mjekesore	1,200,000	730,000	470,000
6021009	Materiale dhe pajisje laboratorike te sherbimit publik	1,200,000	1,200,000	
6021010	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	250,000		250,000
6021099	Produkte të dizenuara (suvenire) për organizime të ndryshme për nevojat e USH-së	120,000	120,000	
6021099	Te tjera materiale speciale	120,000		120,000
6021099	Te tjera sherbime speciale	61,493,430	58,743,430	2,750,000
602.2	Sherbime nga te trete	9,000,000	9,000,000	
6022001	Elektricitet	4,000,000	4,000,000	
6022002	Uje	3,500,000	3,500,000	0
0	Sherbime rrjeti RASH	500,000	500,000	
0	Telefoni Celulare	523,500	523,500	
0	Internet	200,000	200,000	
6022004	Posta dhe sherbimi korrier	12,000,000	10,000,000	2,000,000
6022005	Sherbim per ngrohje	29,969,930	29,969,930	
6022008	Sherbime te sigurimit dhe ruajtjes	1,200,000	450,000	750,000
6022009	Sherbime te dezinfektimit, pastrimit dhe gjelberimit	600,000	600,000	
6022011	Kosto e trajnimit dhe seminareve	2,750,000	2,750,000	0
602.3	Shpenzime transporti	900,000	900,000	
6023100	Karburant per automjetet	400,000	400,000	
6023200	Pjese kembimi, goma dhe bateri	250,000	250,000	
6023300	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	1,200,000	1,200,000	
6023900	Shpenzime te tjera transporti (Mbetjet Kimike)	13,267,500	6,267,500	7,000,000
602.4	Shpenzime udhetimi	8,267,500	6,267,500	2,000,000
6024100	Udhetim i brendshem	5,000,000	0	5,000,000
6024200	Udhetim jashte shtetit+ceopus	24,760,000	12,211,000	12,549,000
602.5	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	24,000,000	11,451,000	12,549,000
6025300	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	120,000	120,000	0
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e ashensorit	120,000	120,000	0
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e pompave	120,000	120,000	0
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e kaldaave	200,000	200,000	0
6025500	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike ( Kontrolli vjetor	200,000	200,000	0
6025600	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	300,000	300,000	0
602.6	Shpenzime per qeramarrje	300,000	300,000	
6026300	Shpenzime per qeramarrje per aparate dhe pajisjet teknike, makine	24,699,000	12,264,100	12,434,900
602.9	Shpenzime te tjera operative	3,600,000	1,840,000	1,760,000
6029001	Shpenzime per pritje e percjellje	120,000	120,000	
6029002	Shpenzime per aktivitate sociale per personelin	2,000,000		2,000,000
6029003	Shpenzime gjygesore	750,000	750,000	
6029004	Shpenzime per sigurimin e ndertesave dhe te tjera kosto sigurimi te	1,000,000	0	1,000,000
6029005	Shpenzime per honorare	7,000,000		7,000,000
6029007	Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca (kerkim shkencor)	10,229,000	9,554,100	674,900
6029008	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni (tarike ak			
	<b>Totali</b>	<b>142,290,963</b>	<b>105,097,063</b>	<b>37,193,900</b>







Zëri "Shpenzime për tatime & taksa të paguara nga Institucioni është parashikuar në vlerën 10.2 milionë lekë për akreditimin e programeve të studimit, kërkesën për hapjen e programeve të reja dhe tksa e tarifa të parashikuara për këtë zë.

#### ➤ **Bursat e studentëve – Artikulli 606**

Në këtë artikull përfshihen bursat financiare të studentëve (transferta tek individët) për Ciklin e parë të studimeve. Fondi është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit në vlerën 49,789 mijë lekë dhe diferenca e trashëguar nga viti 2023 në vlerën 26,685 lekë gjithsej 76,474 mijë lekë.

Kërkesat e studentëve që përfitojnë bursë financiare e përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit me kritere të tjera dhe me rezultate janë përpunuar nga komisioni dhe janë hartuar listat përkatëse për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Aplikimet e studentëve me kritere të tjera janë dërguar në institucionet të cilët kanë detyrimin ligjor për konfirmim të kritereve për të cilat kanë deklaruar online studentët:

#### ➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231**

Investimet kryhen nga Universiteti duke i përballuar me fonde, të cilat financohen nga të ardhurat e Universitetit dhe parashikohen në vlerën 155,200.65 mijë leke. Vlera prej 41,926,295 lekesh është për zërat që janë realizuar brenda vitit 2023 dhe këto vit janë vetëm për tu bërë pagesat. Në krahasim me relacionin e dërguar me datë 21 Mars 2024, ka ndryshim për:

-Tek Zeri "Laboratori i analizave të ushqimeve pjesa 2" është vendosur vlera e tenderuar prej 11,000,000 leke.

-Eshtë shtuar zeri "Laboratori i ushqimit dhe pijeve fakulteti ekonomik" në vlerën 9,111,000 leke.



Emertimi i projektit te investimit	Projekt Buxheti 2024	
	Buxhet	Ardhura
		4,506,360
Pajisje per inventar ekonomik		3,954,000
Furnizim Vendosje Kondicionere		180,343
Supervizim ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave		11,367,266
Investim per ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave		11,418,326
Rikontruksion catia e FSHE		11,000,000
Laboratori i analizave te ushqimeve pjesa 2 (Projekt AKKSHI)		37,313,842
Pajisje elektronike		3,000,000
Blerje libra		700,000
Brava elektronike Fakulteti I Drejtësisë		62,500
TVSH REACH, materiale promovuese		1,375,000
TVSH projekti REACH pajisje		600,000
TVSH projekti BIOSIN pajisje		408,000
TVSH projekti SMART pajisje		300,000
Pajisje Projekti REACH (F.V Banak)		14,490,000
Digitalizimi I anatomise kardiace fetale dhe pediatrike, reabilitimi post kirurgjikal		26,957
Kolaudim ndricim te objekteve dhe tabelave emertuese te ndertesave		290,346
Mbikqyrje punimesh "Rikonstruksion catia FSHE"		28,000
Kolaudim punimesh Catia FSHE		5,991,400
Pajisje per Laboratori I programit dyvjecar SRRK		8,334,000
Pajisje per Salla e Senatit instalim I pajisjeve elektronike		3,503,429
Pajisje per Laboratori i Muzikes		2,953,000
Pajisje per Laboratori i Multimedias		470,000
Pajisje per Laboratori Grafika		620,000
Pajisje per Laboratori I fotografise		250,000
Pajisje per Laboratori I tekstilit		500,000
Pajisje Laboratori SURSH		1,100,000
Pajisje Laboratori Zoologjia		572,550
Pajisje laboratori I fizioterapise		3,000,000
Furnizim Vendosje Perde		8,000,000
Blerje automjeti 30+1 per sherbim ndaj studenteve		700,000
Blerje automjeti per transport mallrash		1,200,000
Pajisje sportive dhe gjimnastike		708,000
Inventarizimi I ornitofaunes sipas habitateve ne Liqenin e Shkodres		832,406
Percaktimi I parametereve fizike, kimike biologjik dhe mikrobiologjik I ujrave te lumit Buna		559,640
Percaktimi I parametrave fiziologjik te disa peshqve te tregut ne liqenin e Shkodres		200,000
Kamera+Aparat fotografik zyra e mardhenieve me publikun		604,032
Permiresimi I infrastruktures se laboratorit te anatomise		150,000
Roll up		240,000
Sherbime te rivelimt topografik kadastrale		150,000
Blerje vegla pune		2,212,788
Laboratori I Multimedias FSHN		1,420,000
Pajisje lab per ekzaminime fiziko - fiziologjike ne aktivitet e sport ne fushen e kerkimit shkencor		300,000
Tra elektrik me telekomande		497,468
Permiresimi i infrastruktures se laboratorit te anatomise permes blerjeve te disa pajisjeve		9,111,000
Laboratori i Ushqimit dhe pijeve fakulteti Ekonomik		155,200,663
<b>TOTAL</b>		

